
VENDIMET E KUVENDIT TË RREGULLT 2020 DHE ATI ZGJEDHOR 2021 28 SHKURT 2021

Vendimi Nr. 2021-01

Kuvendi me shumicë votash mori vendim:

1. Të miratojë komisionin për mbarëvajtjen e punës i cili do shërbejë edhe për të udhëhequr procesin zgjedhor;
2. Anëtarë të komisionit për mbarëvajtjen e punës u zgjodhën: 1) Argjend Lecaj, 2) Astrit Xërxa dhe 3) Festim Ibrahim.

Vendimi Nr. 2021-02

Kuvendi me shumicë votash mori vendim:

1. Të miratojë Raportin e Punës 2020 dhe Raportin Përfundimtar Financiar 2020 të paraqitur në Kuvend.
2. Raportet e sipërpërmendura t'i dërgohen të gjithë anëtarëve dhe komunitetit të tenisit.
3. Raporti përfundimtar financiar, i audituar, të finalizohet deri më 31 mars 2021 dhe të publikohet.

Vendimi Nr. 2021-03

Kuvendi me shumicë votash mori vendim:

1. Të miratojë Planin e Aktiviteteve dhe Buxhetin 2021, me mundësi rishikimi dhe plotësimi nga Kryetari i ri i FTK-së.

Vendimi Nr. 2021-04

Kuvendi me shumicë votash mori vendim:

1. Të miratojë Raportin e Punës për periudhën 2017-2020;

Vendimi Nr. 2021-05

Emërimi i z. Jeton Hadërgjonaj – Kryetar i FTK-së

Në përputhje me nenin 7. të statutit të FTK-së, në Kuvendin zgjedhor të FTK-së, i mbajtur më 28 shkurt 2021 në "Sirius", pas votimeve të gjithsejtë 34 delegatëve, rezultatit 17:17 dhe pasi që z. Rexhepi (kandidati për kryetar) heçi dorë nga gara, z. Jeton Hadërgjonaj u emërua Kryetarin e ri i FTK-së për mandatin 2021-2024,

Z. Hadërgjonaj do të ushtrojë këtë detyrë në mandat katër (4) vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Vendimi Nr. 2021-06

Emërimi i znj. Blerina Mati – Nënkyetare e FTK-së

Bazuar në rekomandimin e Kryetarit z. Jeton Hadërgjonaj dhe në përputhje e nenin 6.2.3. të statutit të FTK-së në kuvendin zgjedhor të datës 28 shkurt 2021 znj. Blerina Mati emërohet me shumicë votash nënkryetare e FTK-së për mandatin 2021-2024, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Vendimi Nr. 2021-07

Emërimi i z. Ylber Shamolli – Nënkyetar i FTK-së

Bazuar në propozimet e kuvendit dhe në përputhje e nenin 6.2.4. të statutit të FTK-së në kuvendin zgjedhor të datës 28 shkurt 2021 z. Ylber Shamolli emërohet me shumicë votash nënkryetar i FTK-së për mandatin 2021-2024, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Vendimi Nr. 2021-08

Emërimi i z. Driton Latifi anëtar bordi i FTK-së

Bazuar në propozimet e kuvendit dhe në përputhje e nenin 6.2.4. të statutit të FTK-së në kuvendin zgjedhor të datës 28 shkurt 2021 z. Driton Latifi riemërohet me shumicë votash anëtar i bordit të FTK-së edhe për një mandat.

Vendimi Nr. 2021-09

Emërimi i z. Lorik Haxhishabani anëtar bordi i FTK-së

Bazuar në propozimet e kuvendit dhe në përputhje e nenin 6.2.4. të statutit të FTK-së në kuvendin zgjedhor të datës 28 shkurt 2021 z. Lorik Haxhishabani emërohet me shumicë votash anëtar i bordit të FTK-së për mandatin 2021-2024, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Vendimi Nr. 2021-10

Plotësimi i anëtarëve të bordit

Bazuar dhe në përputhshmëri me statutin e FTK-së për propozimet e Kryetarit për anëtar të bordit merret vendim që propozimet të bëhen në një mbledhje online të organizuar me delegatët e kuvendit gjatë ditëve në vijim.

Kryetari z.Jeton Hadërgjonaj do të plotësojë bordin edhe me dy (2) anëtarë të tjerë sipas pikës 6.2.3. të statutit.

Vendimi Nr. 2021-11

Emërimi i anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës

Bazuar dhe në përputhshmëri me pikën 9.1. të statutit të FTK-së kuvendi me shumicë votash emëron anëtarët e komisionit mbikëqyrës për mandatin 2021-2024:

1. Genis Nallbani
2. Art Baruti
3. Senad Jusufi

Vendimi Nr. 2021-12

Anëtarësimi i klubeve të reja në FTK

Bazuar dhe në përputhshmëri me pikën 3.1. të statutit të FTK-së kuvendi me shumicë votash aprovon kërkesat e tre (3) klubeve në pritje për anëtarësim në federatë:

1. KT Bifurkacioni -Ferizaj,
2. KT Istogu- Istog
3. KT Vushtrria- Vushtrri

Aktiviteti i klubeve të reja do të përcjellët në tërë vitin dhe në rast mungese të angazhimit ato do suspendohen nga federata në fund vit.